

I. DOKUMENTACIONI LIGJOR DHE TEKNIK

Operatori ekonomik/bashkimi i operatoreve ekonomik që do të marrë/marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes së ofertave nga operatorët e specializuar për “Festivalin e Gjirokastrës” përmban:

- ✓ Ekstrakt të QKR
- ✓ Historik QKR
- ✓ Vërtetim për pagimin e tatim taksave
- ✓ Kontrata për aktivitete artistiko kulturore të përmasave të ngjashme sipas specifikimeve teknike të kërkuara për tre vitet e fundit.
- ✓ Të ketë/kenë jo më pak se 8 punëtorë të siguruar (gje që do garantonte një organizim perfekt të këtij aktiviteti)
- ✓ Pasqyrat financiare të vitit 2014 të certifikuar nga Drejtoria e tatimeve, dhe vërtetim Xhiro për tre vitet e fundit
- ✓ Deklarate ligjore që subjekti i siguron pajisjet për ditët e realizimit të aktivitetit.
- ✓ Sigurimin e ofertës në masën 3% të vlerës totale të fondit limit në formën e garancisë bankare apo në agjenci sigurimesh. Sigurimi i ofertës do të ngurtësohet për 30 ditë nga dita e paraqitjes së ofertës në emër të Ministrisë së Kulturës. Sigurimi i ofertës do të mbahet nga Ministria e Kulturës në rast se operatori i shpallur fitues do të tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës.
- ✓ Vërtetim nga OSSHE janë paguar detyrimet e energjisë elektrike të muajit të fundit përpara shpalljes.

Operatori që merr pjesë në konkurrim përveç dokumentacionit të përgjithshëm duhet të paraqesë:

- ✓ Përshkrim i kompanisë dhe CV e saj ku të specifikohet eventet që ka realizuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Vec kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomike, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operatoreve ekonomike është krijuar zyrtarisht ku të përcaktohen detyrimet dhe angazhimet e secilit;

b. Prokura e posacme.

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE SHERBIMIT TE KERKUAR

Operatori ekonomik/bashkimi i operatoreve ekonomik që do të marrë/marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes së ofertave nga operatorët e specializuar për “Festivalin e Gjirokastrës” përmban:

1. Kontrata të ngjashme ne evenimente me rendesi kombetare.
2. Dokument që vërteton se subjekti ka bashkëpunuar më parë me Ente Shtetërore/private per evenimente te ngjashme.
3. Të ketë të minimalisht 4 vjet që ushtron aktivitet tregtarë në Shqipëri në organizimin eventeve.
4. Te kete organizuar te pakten nje eveniment kulturor kombetar/nderkombetar (festival, ekspozite, panair);

Mungesa qoftë dhe e njërit të dokumentacionit të kërkuar në pikat I dhe II përbën kusht skualifikues.

Shënim: Dokumentacioni ligjor duhet te origjinal apo fotokopje i noterizuar i lëshuar jo me vone se tre muaj nga data e përcaktuar për hapjen e ofertave. Sigurimi i ofertës te jete origjinal.

Dokumentacioni duhet te vij ne nje zarf ku te percaktohet institucioni qe i drejtohet, objekti i konkurimit, si dhe emri i ofertuesit. Zarfi duhet te jete u mbyllur dhe i vulosur nga ofertuesi.